

## Agim Canaj: Vllaznia dhe Partizani kane njesoj shance per kualifikim

nga AlbaniaSoccer

E martë, 17 Dhjetor 2013 21:45

---



Agim Canaj e shikon si te barabarte ndeshjen me Partizanin. Per teknikun e Vllaznise, e dyja skuadrat jane te favorizuara njesoj. “Do te jete nje ndeshje e barabarte. Ne kemi si objektiv kualifikimin por Partizani eshte nje skuader e forte dhe nuk do te jete aspak e lehte. Na duhet te japim me te miren tone dhe vetem keshtu mund te kalojme kete pengese te veshtire. Skuadra ka luajtur mire ne ndeshjen e fundit dhe kjo na jep besim tek fitorja, por nuk do te jete aspak e lehte. Une mendoj se te dy ekipet kane 50 perqind shance per tu kualifikuar ne kete takim”, ka thene Canaj.